



YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS
NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
INICIJATIVA MLADIH ZA LJUDSKA PRAVA

RISHIKIMI I PLAN-PROGRAMEVE MËSIMORE

ANALIZA E PLAN-PROGRAMEVE MËSIMORE - KLASA E DHJETË

PRISHTINË
DHJETOR, 2016

Ky raport u mundësua nga Programi i Angazhimit për Barazi - E4E, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID dhe implementuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC. Përmbajtja është përgjegjësi e Nismës së të Rinjve për të Drejta të Njeriut në Kosovë – YIHR KS dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC, USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



RISHIKIMI I PLAN-PROGRAMEVE MËSIMORE

ANALIZA E PLAN-PROGRAMEVE MËSIMORE – KLASA E DHJETË

HYRJE

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë - YIHR KS¹, nga mesi i vitit 2016 ka ndërmarrë iniciativën dhe është duke zbatuar programin “Pjesëmarrja e të rinjve në edukim gjithëpërfshirës”, program ky i mbështetur nga USAID/ATRC në kuadër të Programit të USAID-it Angazhimi për Barazi (E4E).

Komponenta e parë e këtij programi është identifikimi, analizimi dhe adresimi i gjuhës diskriminuese në programet dhe tekstet shkollore të nivelit parauniversitar, përkatësisht Arsimit të Mesëm të Lartë (Klasat X-XII)². Arsyeja për ndërmarrjen e një iniciative të tillë kanë qenë rastet kur nga individ e organizata të ndryshme është bërë identifikimi i gjuhës diskriminuese në tekstet shkollore. Duke pas parasysh këtë situatë YIHR KS ka vendosur që të përdorë një qasje sistematike të identifikimit të gjuhës diskriminuese, analizimit të saj dhe ofrimit të rekomandimeve konkrete për përmirësimin e kësaj gjuhe në programet dhe tekstet shkollore parauniversitare.

Si hap të parë YIHR KS ka vendosur komunikimin dhe ka realizuar takime njoftuese me zyrtarët e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - MASHT. Në këtë kontekst zyrtarët e YIHR KS kanë realizuar takime me ish Zëvendës Ministren e Arsimit znj. Anila Statovci dhe znj. Feime Llapashtica - Zyrtare për plan-programe dhe zyrtarë të tjerë në kuadër të kësaj ministrie. YIHR KS është informuar që plan-programi për klasat e dhjeta është në përfundim e sipër nga ana e komisioneve profesionale, ku YIHR KS i është dhënë qasje në këtë draft-dokument.

¹ Për më shumë rreth organizatës ju lutem vizitoni ueb faqen në vegzën e bashkangjitur: www.yihr-ks.org

² Kuvendi i Republikës së Kosovës (2011). LIGJI NR. 04/L-032 PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS. url.: <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>

Pas ofrimit të qasjes në këto dokumenta nga ana e MASHT, stafi i YIHR KS gjatë muajit nëntor-dhjetor të vitit 2016 është fokusuar në analizimin e plan-programit për lëndët Histori (klasa e dhjetë, gjimnazi i shkencave shoqërore dhe natyrore), Edukatë Qytetare dhe Biologji (gjimnazi i shkencave shoqërore dhe natyrore).

YIHR KS gjatë këtij procesi është fokusuar në identifikimin e gjuhës diskriminuese dhe ofrimin e rekomandimeve për përmirësim në kuadër të secilit kapitull të secilit program lëndor duke përfshirë a) Hyrjen; b) Qëllimin; c) Temat dhe rezultatet e të nxënit; d) Udhëzimet metodologjike; e) Udhëzimet për zbatimin e çështjeve ndër-kurrikulare; f) Udhëzimet për vlerësim; dhe g) Udhëzimet për materialet dhe burimet mësimore.

I. PROGRAMI LËNDOR EDUKATË QYTETARE

Tek kapitulli i parë i këtij programi, përkatësisht tek kapitulli hyrës YIHR KS ka identifikuar se në kuadër të njohurive rreth fenomeneve dhe proceseve që ofrohen në këtë lëndë mungon faktori i të drejtave të njeriut. Me këtë YIHR KS ka propozuar që ky faktor të përfshihet në kuadër të këtij kapitulli.

“Përmbajtjet mësimore të kësaj lënde ofrojnë njohuri për fenomenet dhe proceset sociale që lidhen me zhvillimin e popullsisë, shtetit, ligjit, qeverisjes, demokracisë, vendimmarrjes, qytetarisë, kulturës, mediave, mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm”.

Burimi: MASHT 2016. Programi lëndor Edukatë qytetare. Klasa e dhjetë.

“Përmbajtjet mësimore të kësaj lënde ofrojnë njohuri për fenomenet dhe proceset sociale që lidhen me zhvillimin e popullsisë, shtetit, ligjit, qeverisjes, demokracisë, vendimmarrjes, qytetarisë, të drejtat e njeriut, kulturës, mediave, mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm”.

Rekomandimi i YIHR KS

YIHR KS e sheh futjen e të drejtave të njeriut në kuadër të këtij kapitulli si njohje e asaj që nxënësit marrin njohuri gjatë vijimit të këtij programi. Pra, në pjesën përmbajtjesore edhe lëndore të këtij programi nxënësit marrin njohuri bazike mbi të drejtat e njeriut, mirëpo që në hyrje të këtij dokumenti nuk njihet si i tillë. YIHR KS beson se njohja dhe prezantimi i komponentës së të drejtave të njeriut në këtë kapitull ndihmon në arritjen e ndërtimit të një kulture universale të të drejtave të njeriut duke nxitur veprime të drejtuara në forcimin dhe respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, tolerancës, barazisë dhe paqes tek individi dhe shoqëria.

Tek kapitulli i dytë i këtij dokumenti, përkatësisht tek qëllimi, YIHR KS tek pjesa se çfarë synohet të arrihet më këtë lëndë ka identifikuar se njëri nga synimet e kësaj

lënde është edhe zhvillimi “moral” i individit. Në vend të këtij koncepti YIHR KS ka propozuar që të përdoret zhvillimi “etik” i individit në vend të atij “moral”.

“Programi i Edukatës qytetare për klasën e 10 synon zhvillimin personal, moral dhe social të nxënësit, me qëllim për ta bërë qytetar të përgjegjshëm.”

Burimi: MASHT 2016. Programi lëndor Edukatë qytetare. Klasa e dhjetë.

“Programi i Edukatës qytetare për klasën e 10 synon zhvillimin personal, “etik” dhe social të nxënësit, me qëllim për ta bërë qytetar të përgjegjshëm”.

Rekomandimi i YIHR KS

Duke pas parasysh që në bazë të Kushtetutës së saj Kosova është shtet sekular dhe duke pas parasysh dilemat dhe diskutimet filozofike dhe shkencore rreth dallimeve të konceptit moral, ku shumica e literaturës filozofike e shkencore përkufizojnë këtë term si të lidhur ngushtë dhe që ka konotacion religjioz dhe jo shkencor e edukativ. Për të evituar këtë YIHR KS ka propozuar që të përdoret koncepti etik në këtë pjesë të këtij kapitulli sepse etika është standard i jashtëm ku për shembull, mësimmshënësit/et, policët/et, mjekët/et dhe të gjithë duhet të ndjekin një kod etik të përcaktuar nga profesioni i tyre, pavarësisht ndjenjave apo preferencave të tyre morale.

Tek kapitulli i tretë i këtij programi, përkatësisht tek kapitulli rreth temave dhe rezultateve të të nxënës, tek pika 1. Hulumton strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to, ku analizohet dhe nxirren përfundime për ndikimin e personaliteteve të ndryshme YIHR KS ka identifikuar se përmendet koncepti “kombëtar” dhe evitohet aspekti “rajonar”.

“Analizon dhe nxjerr përfundime për ndikimin e personaliteteve të shquara historike, shoqërore, politike, kulturore e arsimore, kombëtare e botërore, gjatë periudhave të ndryshme historike”.

Burimi: MASHT 2016. Programi lëndor Edukatë qytetare. Klasa e dhjetë.

“Analizon dhe nxjerr përfundime për ndikimin e personaliteteve të shquara historike, shoqërore, politike, kulturore e arsimore, “vendore”, “rajonale” dhe botërore, gjatë periudhave të ndryshme historike”.

Rekomandimi i YIHR KS

YIHR KS në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që e përcakton Kosovën si shtet multi-etnik propozon që në vend të konceptit “kombëtar” të vendoset koncepti “vendor”, në mënyrë që të evitohet konotimi mono-etnik në këtë pjesë. Gjithashtu YIHR KS propozon të shtohet pas vendor edhe rajonal (që përfshin shtetet fqinje të Kosovës).

Gjithashtu tek ky kapitull, tek pjesa 3. Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat e rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet, ku flitet për hulumtimin e të dhënave që ndërlidhen me identitetin, YIHR KS ka identifikuar se në këtë pjesë mungojnë klasa socio-ekonomike, raca, gjinia dhe gjuha.

“1. Hulumton të dhënat që ndërlidhen me identitetin si: traditat, rregullat, besimet, mitet, legjendat, arkitekturën autoktone, monumentet, veshjet, ushqimet, etj., e popullit të vet dhe të popujve të tjerë; shpjegon vlerat e identitetit kombëtar, rajonal, evropian dhe global”.

Burimi: MASHT 2016. Programi lëndor Edukatë qytetare. Klasa e dhjetë.

“1. Hulumton të dhënat që ndërlidhen me identitetin si: klasa socio-ekonomike, raca, gjinia, gjuha, traditat, rregullat, besimet, mitet, legjendat, arkitekturën autoktone, monumentet, veshjet, ushqimet, etj., e popullit të vet dhe të popujve të tjerë; shpjegon vlerat e identitetit kombëtar, rajonal, evropian dhe global”.

Rekomandimi i YIHR KS

YIHR KS ka dhënë këtë propozim bazuar në faktet e njohura shkencore nga fusha sociale se klasa dhe statusi socio-ekonomik, raca, gjinia dhe gjuha janë pjesë e identitetit që rrjedh nga mënyra se si njerëzit janë të organizuar në grupet sociale.

Ndërsa tek tema Ligji, drejtësia dhe përgjegjësia, YIHR KS propozon që në pjesën e fundit që flet për rolin e organeve të drejtësisë për funksionimin e ligjit në shtetin demokratik të shtohet dhe shtjellohen parimet bazike për qasje në drejtësi nga qytetarët e Kosovës. Bazuar në raportet vendore e ndërkombëtare qasja në drejtësi është praktikë e re për kosovarët dhe për këtë ekziston njohuri e nivelit të ultë dhe qasje shpërfillëse e institucioneve sa i përket të drejtës së qasjes së qytetarëve në drejtësi. Në bazë të Kushtetutës së Kosovës, përkatësisht nenit 102.2 thuhet se sistemi i drejtësisë është pushtet i pavarur, i drejtë, apolitik që siguron qasje të barabartë për të gjithë në këtë sistem. Qasja në drejtësi sipas Kushtetutës së Kosovës është një e drejtë obligative dhe duhet të i ofrohet secilit qytetar të Kosovës në mënyrë të barabartë.

VËREJTJE: YIHR KS propozon që i gjithë dokumenti të shkruhet në formë gjithëpërfshirëse duke u bazuar në aspektin gjinor si p.sh. Mësimdhënës/e.

II. PROGRAMI LËNDOR HISTORI - GJIMNAZI SHOQËROR-GJUHËSOR

Tek kapitulli i parë i këtij programi, përkatësisht tek kapitulli hyrës YIHR KS ka identifikuar se në kuadër të pjesës ku flitet për atë së çfarë njohurish përfitojnë nxënësit për gjatë ndjekjes së kësaj lënde përmendet koncepti “shpirtëror” kurse YIHR KS propozon që kjo të zëvendësohet me konceptin “kulturor”.

“Përmes kësaj lënde nxënësit do të fitojnë njohuri për veprimtarinë e njeriut dhe shoqërisë njerëzore në të gjitha rrafshet, si atë ekonomik, shoqëror, shpirtëror, politik, institucional etj., si dhe për rolin e ambientit natyror në këto zhvillime.”

Burimi: MASHT 2016. Programi lëndor Histori - Gjimnazi shoqëror-gjuhësor.

“Përmes kësaj lënde nxënësit do të fitojnë njohuri për veprimtarinë e njeriut dhe shoqërisë njerëzore në të gjitha rrafshet, si atë ekonomik, kulturor, politik, institucional etj., si dhe për rolin e ambientit natyror në këto zhvillime.”

Rekomandimi i YIHR KS

YIHR KS ka dhënë këtë propozim bazuar në faktin se tradicionalisht koncepti “shpirtëror” në shkencat moderne nuk përmendet më sepse ai është i lidhur ngushtë më shpjegimet religjioze dhe në vend të këtij koncepti YIHR KS ka propozuar që të përdoret koncepti “kulturor” i cili tashmë zëvendëson në shkencë atë që më herët ka përfaqësuar termi shpirtëror.

Tek kapitulli i dytë i këtij dokumenti, përkatësisht tek qëllimi, YIHR KS tek pjesa ku thuhet se qëllimi është që nxënësi/ja do të zhvillojë aftësi, e shkathtësi, e vlera dhe e qëndrime të nxënësit të cilët do të respektojnë identitetet dhe përkatësitë e ndryshme është identifikuar koncepti idenititar “seksual” dhe YIHR KS ka propozuar që kjo të zëvendësohet me terminologjinë shkencore “orientim seksual”.

“...gjë që do të ndikojë në zhvillimin e aftësive, e shkathtësive, e vlerave dhe e qëndrimeve të nxënësit si një personalitet i qëndrueshëm dhe qytetar i përgjegjshëm, i cili do të respektojë identitetet dhe përkatësitë e ndryshme, si ato: gjinore, etnike, racore, shoqërore, kulturore, të besimit, seksuale etj”.

Burimi: MASHT 2016. Programi lëndor Histori - Gjimnazi shoqëror-gjuhësor.

“...gjë që do të ndikojë në zhvillimin e aftësive, e shkathtësive, e vlerave dhe e qëndrimeve të nxënësit si një personalitet i qëndrueshëm dhe qytetar i përgjegjshëm, i cili do të respektojë identitetet dhe përkatësitë e ndryshme, si ato: gjinore, etnike, racore, shoqërore, kulturore, të besimit, orientim seksuale etj”.

Rekomandimi i YIHR KS

Sipas Asociacionit Amerikan të Psikologëve “orientimi seksual ka të bëjë me model të qëndrueshëm identiteti që lidhet me tërheqjet emocionale, romantike, ose seksuale nga burrat, gratë, apo të dyja gjinitë”. Ndërsa vetëm termi *seksual* përkufizon vetëm aktin e marrëdhënies seksuale.

Tek kapitulli i tretë i këtij programi, përkatësisht tek kapitulli rreth temave dhe rezultateve të të nxënësit, tek pika 1. Hulumton strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to, ku analizohet dhe nxirren përfundime për ndikimin e personaliteteve të ndryshme YIHR KS ka identifikuar se përmendet koncepti “kombëtar” dhe evitohet aspekti “rajonal”.

“Analizon dhe nxjerr përfundime për ndikimin e personaliteteve të shquara historike, shoqërore, politike, kulturore e arsimore, kombëtare e botërore, gjatë periudhave të ndryshme historike”.

Burimi: MASHT 2016. Programi lëndor Histori - Gjimnazi shoqëror-gjuhësor.

“Analizon dhe nxjerr përfundime për ndikimin e personaliteteve të shquara historike, shoqërore, politike, kulturore e arsimore, “vendore”, “rajonale” dhe botërore, gjatë periudhave të ndryshme historike”.

Rekomandimi i YIHR KS

YIHR KS në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që e përcakton Kosovën si shtet multi-etnik propozon që në vend të konceptit “kombëtar” të vendoset koncepti “vendor”, në mënyrë që të evitohet konotimi mono-etnik në këtë pjesë. Gjithashtu YIHR KS propozon të shtohet pas vendor edhe rajonal (që përfshin shtetet fqinje të Kosovës). Ky rekomandim vlen gjithashtu edhe për pikën 6. Shfrytëzon në mënyrë efektive TIK-un dhe teknologjitë e tjera bashkëkohore, përkatësisht pikën 6.1.

Tek kapitulli i tretë, tema “Parahistoria - Bashkësitë e para njerëzore”, YIHR KS propozon që të identifikohet dhe përshkruhet ndarja e roleve gjinore dhe pasojat negative të kësaj ndarje të roleve gjatë dhe pas kësaj periudhe historike. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) i definon rolet gjinore si "role të ndërtuara shoqërore, sjellje, aktivitete dhe attribute që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për burrat dhe gratë. Pra, në këtë kontekst është e rëndësishme të trajtohet sjellja e burrave dhe grave, statusi i tyre si dhe pushteti i tyre në parahistori.

Po ashtu tek ky kapitull, tek tema “Gjergj Kastrioti -Skënderbeu dhe epoka e tij”, YIHR KS tek pjesa ku thuhet “argumenton bashkëpunimin shqiptaro-evropian gjatë epokës së Gjergj Kastriotit- Skënderbeut...” propozon që të qartësohet koncepti i kombit shqiptar gjatë kësaj periudhe duke pasur parasysh së në këtë periudhë nuk ka dokumente historike që tregojnë për ekzistencën e konceptit “komb” ose që historiani Nelson R.Çabej në artikullin “Prejardhja dhe natyra e kombit” thotë se për këtë periudhë historike “mund të flasim për një komb arbëror mesjetar”. Gjithashtu tek kjo temë YIHR KS propozon që në këtë program përderisa është e nevojshme të flitet për arbërit si etni, është e nevojshme të dihet edhe për ekzistencën e etnive tjera në këtë periudhë nëse ka pasur ose jo, si janë identifikuar, karakteristikat e tyre etj.

Tek i njëjti kapitull tek pjesa ku trajtohen “Proceset shoqërore dhe natyrore”, tek pika 2.1. ku thuhet “Analizon në mënyrë kritike shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve, dukurive dhe proceseve të ndryshme në shoqëri dhe shpreh opinionet personale” YIHR KS propozon që fjalia “shpreh opinionet personale” të evitohet nga kjo pjesë sepse në

Histori nuk vlej në opinionet personale mirëpo argumentet dhe faktet empirikisht të vërtetuara, në të kundërtën ekziston rreziku që në libra të pasqyrohet një anshëm një ngjarje e caktuar historike.

“2.1. Analizon në mënyrë kritike shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve, dukurive dhe proceseve të ndryshme në shoqëri dhe shpreh “opinionet personale” për ndikimet e tyre në individë, në sisteme shoqërore dhe në zhvillime globale”

Burimi: MASHT 2016. Programi lëndor Histori - Gjimnazi shoqëror-gjuhësor.

“2.1. Analizon në mënyrë kritike shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve, dukurive dhe proceseve të ndryshme në shoqëri dhe për ndikimet e tyre në individë, në sisteme shoqërore dhe në zhvillime globale”.

Po ashtu tek e njëjta pjesë tek pika 3.1. YIHR KS propozon që të shtohet edhe faktorët tjerë që kanë të bëjnë me identitetin si klasa socio-ekonomike, raca, gjinia, gjuha etj. Kjo bazuar në faktet e njohura shkencore nga fusha sociale se klasa dhe statusi socio-ekonomik, raca, gjinia dhe gjuha janë pjesë e identitetit që rrjedh nga mënyra se si njerëzit janë të organizuar në grupet sociale.

YIHR KS tek i njëjti kapitull tek tema “Qytetërimi ilir” ka identifikuar gjuhë dhe etiketim diskriminues në aspektin gjinor ndaj Mbretëreshës Teuta duke e quajtur atë “burrë shteti”. Në këtë kontekst YIHR KS propozon që përkufizimi si “burrë shteti” për Mbretëreshën Teuta të hiqet dhe të përdoret koncepti “udhëheqëse e Mbretërisë”. Përpos angazhimit të saj të ofrohet hapësirë më e madhe për mënyrën e udhëheqjes së Mbretëreshës Teuta si dhe fatin e saj pas luftërave Ilir-Romake. Po tek e njëjta temë tek pika ku thuhet “Përshkruan jetën e përditshme ilire dhe përshkruan specifikat e kulturës dhe besimit ilir, në raport me kulturat dhe besimet e popujve tjerë”, YIHR KS propozon që në këtë pjesë MASHT dhe autorët/et e librave shkollor të Historisë të fokusohen në identifikimin dhe trajtimin e pozitës shoqërore, kulturore, politike dhe ekonomike të fiseve jo-ilire në territorin Ilir gjithashtu.

Gjithashtu sikur tek pjesët tjera edhe në këtë kapitull tek tema 3. Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet, ku flitet për hulumtimin e të dhënave që ndërlidhen me identitetin, YIHR KS ka identifikuar se në këtë pjesë mungojnë klasa socio-ekonomike, raca, gjinia dhe gjuha. Me këtë rast YIHR KS propozon që edhe në këtë rast duke u bazuar në faktet e njohura shkencore nga fusha sociale se klasa dhe statusi socio-ekonomik, raca, gjinia dhe gjuha janë pjesë e identitetit që rrjedh nga mënyra se si njerëzit janë të organizuar në grupet sociale. Ndërsa tek tema Besimet dhe religjionet YIHR KS propozon që në këtë pjesë të përshkruhet përhapja e feve tjera siç janë: judaizmi, budizmi, hinduizmi etj. Kjo sepse tani zyrtarisht në botë historia dhe shkencat tjera të ndërlidhura njohin 5 fetë më të rëndësishme dhe më të shtrira në botë ku përfshihen krishterimi, islami, judaizmi, budizmi dhe hinduizmi. Përpos kësaj tek tema Demokracia në Greqinë antike, YIHR KS propozon që të identifikohen individët apo grupet shoqërore që nuk kanë mundur të marrin pjesë në jetën dhe proceset e sistemit demokratik në Athinën Antike (sidomos fokus te veçantë të i jepet statusit të grave, fëmijëve, të huajve dhe skllavëve).

VËREJTJE: YIHR KS propozon që i gjithë dokumenti të shkruhet në formë gjithëpërfshirëse duke u bazuar në aspektin gjinor si p.sh. Mësimdhënës/e.

III. PROGRAMI LËNDOR HISTORI - GJIMNAZI I SHKENCAVE NATYRORE

Tek kapitulli i dytë i këtij dokumenti, përkatësisht tek qëllimi, YIHR KS tek pjesa ku thuhet se qëllimi është që nxënësi/ja do të zhvillojë aftësi, e shkathtësi, e vlera dhe e qëndrime të nxënësit të cilët do të respektojnë identitetet dhe përkatësitë e ndryshme është identifikuar koncepti identitar “seksual” dhe YIHR KS ka propozuar që kjo të zëvendësohet me terminologjinë shkencore “orientim seksual”.

“...gjë që do të ndikojë në zhvillimin e aftësive, e shkathtësive, e vlerave dhe e qëndrimeve të nxënësit si një personalitet i qëndrueshëm dhe qytetar i përgjegjshëm, i cili do të respektojë identitetet dhe përkatësitë e ndryshme, si ato: gjinore, etnike, racore, shoqërore, kulturore, të besimit, seksuale etj”.

Burimi: MASHT 2016. Programi lëndor Histori - Gjimnazi i shkencave natyrore.

“...gjë që do të ndikojë në zhvillimin e aftësive, e shkathtësive, e vlerave dhe e qëndrimeve të nxënësit si një personalitet i qëndrueshëm dhe qytetar i përgjegjshëm, i cili do të respektojë identitetet dhe përkatësitë e ndryshme, si ato: gjinore, etnike, racore, shoqërore, kulturore, të besimit, orientim seksuale etj”.

Rekomandimi i YIHR KS

Sipas Asociacionit Amerikan të Psikologëve “orientimi seksual ka të bëjë me model të qëndrueshëm identiteti që lidhet me tërheqjet emocionale, romantike, ose seksuale nga burrat, gratë, apo të dyja gjinitë”. Ndërsa vetëm termi seksual përkufizon vetëm aktin e marrëdhënies seksuale.

Tek kapitulli i tretë i këtij programi, përkatësisht tek kapitulli rreth temave dhe rezultateve të të nxënit, tek pika 1. Hulumton strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to, ku analizohet dhe nxirren përfundime për ndikimin e personaliteteve të ndryshme YIHR KS ka identifikuar se përmendet koncepti “kombëtar” dhe evitohet aspekti “rajonal”.

“Analizon dhe nxjerr përfundime për ndikimin e personaliteteve të shquara historike, shoqërore, politike, kulturore e arsimore, kombëtare e botërore, gjatë periudhave të ndryshme historike”.

Burimi: MASHT 2016. Programi lëndor Histori - Gjimnazi i shkencave natyrore.

“Analizon dhe nxjerr përfundime për ndikimin e personaliteteve të shquara historike, shoqërore, politike, kulturore e arsimore, “vendore”, “rajonale” dhe botërore, gjatë periudhave të ndryshme historike”.

Rekomandimi i YIHR KS

YIHR KS në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që e përcakton Kosovën si shtet multi-etnik propozon që në vend të konceptit “kombëtar” të vendoset koncepti “vendor”, në mënyrë që të evitohet konotimi mono-etnik në këtë pjesë. Gjithashtu YIHR KS propozon të shtohet pas vendor edhe rajonal (që përfshin shtetet fqinje të Kosovës). Gjithashtu YIHR KS propozon të shtohet pas vendor edhe rajonal (që përfshin shtetet fqinje të Kosovës). Ky rekomandim vlen gjithashtu edhe për pikën 6. Shfrytëzon në mënyrë efektive TIK-un dhe teknologjitë e tjera bashkëkohore, përkatësisht pikën 6.1.

Tek i njëjti kapitull tek pjesa ku trajtohen “Proceset shoqërore dhe natyrore”, tek pika 2.1. ku thuhet “Analizon në mënyrë kritike shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve, dukurive dhe proceseve të ndryshme në shoqëri dhe shpreh opinionet personale” YIHR KS propozon që fjalia “shpreh opinionet personale” të evitohet nga kjo pjesë sepse në Histori nuk vlejné opinionet personale mirëpo argumentet dhe faktet empirikisht të vërtetuara në të kundërtën ekziston rreziku që në libra të pasqyrohet një anshëm një ngjarje e caktuar historike.

“2.1. Analizon në mënyrë kritike shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve, dukurive dhe proceseve të ndryshme në shoqëri dhe shpreh “opinionet personale” për ndikimet e tyre në individë, në sisteme shoqërore dhe në zhvillime globale”

Burimi: MASHT 2016. Programi lëndor Histori - Gjimnazi i shkencave natyrore.

“2.1. Analizon në mënyrë kritike shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve, dukurive dhe proceseve të ndryshme në shoqëri dhe për ndikimet e tyre në individë, në sisteme shoqërore dhe në zhvillime globale”.

Po ashtu tek e njëjta pjesë tek pika 3.1. YIHR KS propozon që të shtohet edhe faktorët tjerë që kanë të bëjnë me identitetin si klasa socio-ekonomike, raca, gjinia, gjuha etj. Kjo bazuar në faktet e njohura shkencore nga fusha sociale se klasa dhe statusi socio-ekonomik, raca, gjinia dhe gjuha janë pjesë e identitetit që rrjedh nga mënyra se si njerëzit janë të organizuar në grupet sociale. Po ashtu tek kjo pjesë YIHR KS propozon që në vend të konceptit “identitetit kombëtar” të paraqitet në shumës “identitetet kombëtare” me qëllim përshkrimin, shpjegimin dhe përfshirjen e të gjitha identiteteve kombëtare në vend.

Gjithashtu tek ky kapitull, tek tema Nacionalizmi - formimi i shteteve kombëtare, ku flitet për rolin e nacionalizmit në formimin e shteteve kombëtare në nivel rajonal, evropian dhe botëror, YIHR KS propozon që gjithashtu të përshkruhen edhe pasojat e nacionalizimit karshi komuniteteve jo-shumicë në këto shtete, sidomos pasojat e panacionalizimit dhe nacionalizimit të bazuar në racë. Tek tema Lëvizja Kombëtare Shqiptare në kontekstin e periudhës së pushtimit të Perandorisë Osmane, YIHR KS propozon që karshi përpjekjeve të shqiptarëve të identifikohen dhe prezantohen edhe përpjekjet dhe roli i komuniteteve tjera jo-shqiptare gjatë periudhës së pushtimit osman. Po ashtu edhe tek tema Shqipëria, Kosova dhe viset tjera shqiptare në periudhën e kompozimit të ri politik të Ballkanit 1912-1914, tek definimi i pozitës specifike të shqiptarëve në konfrontimin ballkanik 1912-1913, YIHR KS propozon që të identifikohen, shpjegohen dhe përfshihen edhe pozitat specifike të komuniteteve tjera jo-shqiptare që kanë jetuar në këto vise gjatë kësaj periudhe kohore.

Tek tema Shqipëria dhe shqiptarët gjatë Luftës së Parë Botërore, YIHR KS me qëllim arritjen e gjithpërfshirjes në histori të komuniteteve jo-shqiptare propozon që ndryshohet kjo temë dhe të jetë Shqipëria dhe Kosova gjatë Luftës së Parë Botërore. Gjithashtu tek analiza e angazhimit politik të shqiptarëve, YIHR KS propozon që karshi angazhimit politik të shqiptarëve të analizohet edhe angazhimi politik i komuniteteve

tjera jo-shqiptare gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu edhe tek tema Shqiptarët (Shqipëria, Kosova, viset tjera) ndërmjet dy Luftërave Botërore, tek pjesa e përkufizimit të formatit të rezistencës si dhe organizimin dhe veprimin politik të shqiptarëve, YIHR KS propozon që karshi rezistencës së shqiptarëve të përkufizohet edhe rezistenca e komuniteteve tjera jo-shqiptare për realizimin e të drejtave qytetare dhe kombëtare të tyre. Theks i veçantë duhet vënë në përvojat dhe sfidat që komunitetet kanë kaluar në këtë periudhë, dhe rezistencave të cilat nuk kanë pasur si qëllim shtypjen e komuniteteve tjera. Portretizimi i lëvizjeve të komuniteteve tjera si lëvizje shtypëse ndikon në krijimin e përshtypjeve se komunitete të caktuara janë armiq të “natyrshëm” të një komuniteti, duke anashkaluar faktin se këto ngjarje historike vijnë si pasojë e politikave të asaj kohe dhe rrethanëve shoqërore dhe ekonomike. Tek tema tjetër e këtij programi lëndor që ka të bëjë me Luftën e Dytë Botërore, ndarjen në blloqe dhe Luftën e Ftohtë, YIHR KS propozon që të shtohet edhe një pjesë ku përshkruhet dhe shtjellohen rastet e krimeve të luftës së dytë botërore të zhvilluara në atë që njihen si Gjykimet e Gjykatës së Nurembergut dhe Tokios (1945 - 1948).

Gjithashtu tek tema Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj, tek pjesa ku thuhet që të përshkruhet përfshirja e Kosovës në LDB, zonat e pushtimit dhe pozitën e shqiptarëve në to, YIHR KS propozon që YIHR KS propozon që të përshkruhet edhe pozita e komuniteteve tjera jo-shqiptare që kanë jetuar në Kosovë gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu tek kjo pjesë YIHR KS ka identifikuar që mungon një pjesë shumë e rëndësishme e historisë gjatë luftës së dytë botërore, e ajo është përpjekja dhe suksesi i Shqipërisë në mbrojtjen e hebrenjve, ku Shqipëria është vendi i vetëm në Evropë që gjatë kësaj periudhe ka arritur të ndihmojë dhe të mos dorëzojë hebrenjtë që kanë kërkuar ndihmë. Pra, YIHR KS propozon që të shtohet një pjesë e veçantë ku do të dedikohet kontributit dhe ndihmës së Shqipërisë në mbrojtjen e komunitetit hebre gjatë LDB.

“Përshkruan përfshirjen e Kosovës në LDB, zonat e pushtimit dhe pozitën e shqiptarëve në to”

“Përshkruan përfshirjen e Kosovës në LDB, zonat e pushtimit dhe pozitën e shqiptarëve dhe komuniteteve jo-shqiptare në to”.

Rekomandimi i YIHR KS

Po të e njëjta temë tek pjesa Analizoni programet e formacioneve politiko-ushtarake shqiptare gjatë LDB dhe vizionin e tyre për zgjidhjen e Çështjes Shqiptare në përfundim të luftës, YIHR KS propozon që në këtë pjesë të analizohet edhe roli i shqiptarëve në Koalicionet e lartë-përmendura. Sipas historianit Xhemil Çeli gjatë kësaj periudhe sipas dokumentave historik e praktikë u mobilizuan 5 batalione e një regjiment, gjithsej me rreth 9.000 veta në Shqipëri e Kosovë nën komandën e ushtrisë gjermane. Ndërsa tek periudha post luftës së dytë botërore, përkatësisht tek pjesa që flet për transformimet shoqërore dhe jetën e përditshme të qytetarit të zakonshëm në sistemin komunist, YIHR KS propozon që të përfshihet edhe pjesa e shkeljes së të drejtave të njeriut gjatë kësaj periudhe. Për këtë temë flet edhe Raportuesi i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara për ekzekutimet jashtëgjyqësore, Profesor Philip Alston i cili udhëhoqi Misionin në Shqipëri (15-23 shkurt 2010), ka dorëzuar raportin e nxjerrë nga ky Mision, duke bërë edhe rekomandimet përkatëse për Shqipërinë. Është

pranuar gjerësisht se mijëra shqiptarë janë torturuar, ekzekutuar dhe zhdukur nga shteti, por shumë nga familjet e viktimave nuk kanë arritur të mësojnë fatin e të dashurve të tyre, dhe detajet e shkeljeve të regjimit nuk janë nxjerrë në dritë.

Sa i përket zhvillimeve tjera në Ballkan pas përfundimit të luftës së dytë botërore, YIHR KS propozon që një kapitull i veçantë në kuadër të këtij programi ti dedikohet Themelimit dhe Shpërbërjes së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë duke përfshirë të dhëna historike mbi: Themelimin, strukturën dhe përbërjen e Jugosllavisë; Jetën socio-kulturore në Jugosllavi; Shkeljen e të drejtave të njeriut në Jugosllavi; Rolin e arsimit, shkencës dhe kulturës në sistemin e Jugosllavisë; Fuqizimin e lëvizjeve nacionaliste në Jugosllavi; Procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe luftërat gjatë kësaj periudhe.

Tek tema Kosova 1990-2008: Lindja e një shteti të ri evropian, YIHR KS propozon që të shtohet një pjesë ku vlerësohet lëvizja paqësore gjatë viteve të 90-ta, kontributi i grave dhe studentëve, sistemi paralel arsimor, shëndetësor, kulturor etj. Gjithashtu YIHR KS

insiston që në këtë kapitull të elaborohet me thellësisht fazat e luftës në Kosovë dhe të ofrohen të dhëna të vërtetuara nga disa burime mbi numrin e humbjeve njerëzore përfshirë civilët dhe forcat ushtarake nga të gjitha komunitetet. YIHR KS propozon që në këtë kapitull të elaborohet plani shtetëror i spastrimit etnik përfshirë dëbimin e popullsisë civile shqiptare nga Kosova dhe dëbimi i komuniteteve jo-shqiptare pas përfundimit të luftës në Kosovë. YIHR KS propozon që të përfshihen informata të përgjithshme të Tribunalit të Hagës në rastet që lidhen krimet e luftës në Kosovë.

VËREJTJE: YIHR KS propozon që i gjithë dokumenti të shkruhet në formë gjithëpërfshirëse duke u bazuar në aspektin gjinor si p.sh. Mësimdhënës/e.

IV. PROGRAMI LËNDOR BIOLOGJI

Tek kapitulli i parë i këtij programi, përkatësisht tek kapitulli hyrës YIHR KS ka identifikuar se në kuadër të rolit të mësimdhënësit/eve gjatë trajtimit të çështjeve që

kanë të bëjnë më pubertetin dhe ndryshimet fiziologjike, psikike dhe emocionale të moshës së nxënësve, YIHR KS për shkak të përvojës me nxënës/e të shkollave të mesme insiston që mësuesit/et të mos i anashkalojnë temat që lidhen me ri-prodhimin dhe edukatën seksuale.

Gjithashtu tek tema trashëgimia dhe gjenetika, tek pjesa ku kërkohet të përshkruhen sindromat e njeriut, sidomos tek pjesa për Sindromin e Daunit, YIHR KS nisur nga të dhënat në librat shkollor p.sh. ku kjo sindromë përmendet si “idiotia mongoloide”, përdorimi i termeve raciste gjatë përshkrimit të karakteristikave fizike, propozon që këto të dhënat të përditësohen dhe bazohen në hulumtimet dhe argumentet shkencore. Shembull: Termi “mongol” dhe “Mongoloid” si një term për sindromin Down daton në 1860, kur mjeku i quajtur John Langdon Down publikoi punimin “Vëzhgime mbi Klasifikimin Etnik të Idiotëve”, në të cilën ai pohoi se ishte e mundur të klasifikojnë lloje të ndryshme sipas karakteristikave etnike, duke i krahasuar ata me monoglët. Para kësaj, personat me sindromën Down janë klasifikuar thjeshtë si “idiot”. YIHR KS mos përditësimin e teksteve e bazon në faktin se mjeku Down, më vonë, ka braktisur besimin e tij në frenologji, pas 10 viteve të studimeve dhe i ktheu shpinën mendimit se karakteri i një personi dhe inteligjenca mund të konkludohet nga pamja e jashtme dhe forma e kokës së tij ose të saj. Në vitin 1959 gjenetisti francez Jérôme Lejeune zbuloi shkakun e sindromës Down (një kopje shtesë të kromozomit 21) atë që mjekët filluan ta quanin Idiotësi Mongoloide dhe mongol. Gjenetistë të shquar (duke përfshirë nipin e vet mjekut Down) shkruan një letër të përbashkët për “Lancet”, revistën kryesore të botës mjekësore, duke këmbëngulur se termi ishte ofndues ndaj racave Lindore dhe ka kërkuar një emër të ri për gjendjen. Vetë Mongolia ka bërë thirrje gjithashtu për përmirësim të termit. Pasi anëtarësimi në Kombet e Bashkuara në vitin 1961, Mongolia iu bashkua Organizatës Botërore të Shëndetësisë në vitin 1965 dhe kërkoi që Sindromi Down të mos quhet si “Idioti Mongoloide”, çka edhe ka ndodhur me miratim nga OKB.

Gjithashtu, pjesa ku flitet për jetëgjatësinë e personave me Sindrom Down, duhet të përditësohet gjithashtu në hulumtime shkencore, duke e hequr fare limitin e jetëgjatësisë. Ndërsa tek tema ku flitet për Evolucionin, tek pjesa ku kërkohet të

përshkruhet pema gjenealogjike e primatëve, YIHR KS propozon që ne vend të “racave njerëzore” të përdoret koncepti “karakteristikat njerëzore”.

VËREJTJE: YIHR KS propozon që i gjithë dokumenti të shkruhet në formë gjithëpërfshirëse duke u bazuar në aspektin gjinor si p.sh. Mësimdhënës/e.